



Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët për vitin akademik 2021/2022 Programi: Dizajn Grafik dhe Multimedia

1. Hyrja

Raporti i vlerësimit të cilësisë nga studentët në programin Dizajn Grafik dhe Multimedia përbëhet prej dy pjesëve.

Në pjesën e parë të raportit është paraqitura vlerësimi i përmblodhur për program .

Në pjesën e dytë të këtij raporti është paraqitur dhe përshkruar në mënyrë të detajuar, vlerësimi i stafit akademik për programin Dizajn Grafik dhe Multimedia i ndarë në vite sipas lëndëve për vitet akademike përkatëse.

1.1 Raporti i përmblodhur i vlerësimit të cilësisë

Nga raporti përmblodhur i paraqitur në tabelën nr. 1 në kuadër të fushës së vlerësimit të programit, gjegjësisht të mësimdhënies dhe mësimnxënies shohim një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë nga viti në vit. Duke i u referuar tabelës, përmirësimi i cilësisë është po thuaj se i njëjtë në të tri vitet. Nga analiza krahasuese, shohim se në vitin e fundit akademik kemi pasur një rënie në vlerësim krahasuar me vitin paraprak, por një ngritje të theksuar të përmirësimit të cilësisë kur e krahasojmë me vitin akademik 2019/2020. Edhe te vlerësimi i stafit akademik shohim një trend të rënies së cilësisë krahasuar me vitet akademike 2019/2020 dhe 2020/2021.

Tabela nr.1 Vlerësimi i cilësisë sipas fushave

	Viti aktual	Vitet paraprake	
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Vlerësimi i Mësimdhënies dhe mësimnxënies	3.99	4.38	4.05
Vlerësimi i stafit akademik	4.49	4.28	4.26




Figura nr.1 Trendi i vlerësimit të cilësisë sipas fushave

1.2 Raporti i vlerësimit të Programit për vitin akademik 2021/2022

Vlerësimi i programit është realizuar përmes pyetësorit për vlerësim të programit të vendosur në Sistemin e Menaxhimit Universitar (SMU), i cili përmban 21 komponente. Ky vlerësim realizohet një herë brenda një viti akademik dhe vlerësimi bëhet nga studentët e këtij programi. Pyetjet e vlerësimit të programit janë të ndërtuara kryesisht në formë të pohimeve dhe vlerësimi i tyre është bërë sipas shkallës së likertit (1 - Nuk pajtohem fare; 2 - Nuk pajtohem; 3 - Neutral; 4 - Pajtohem; dhe 5 - Pajtohem plotësisht). Rezultatet e vlerësimeve janë paraqitur në këtë raport përmes tabelave nr.2 dhe 3.

Tabela nr.2 Mësimdhënia dhe Mësimnxënia/ Programi

	Viti aktual	Vitet paraprake	
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Materialet e prezentuara gjatë ligjëratave na jepen rregullisht	4.03	4.59	3.99
Literatura e sugjeruar për lëndët na bëhet e ditur që në fillim të semestrit	4.05	4.65	4.25

Përmbajtja e lëndës (syllabusi) na shpërndalet me kohë	4.02	4.56	4.17
Orari i konsultimeve me profesorë është i shpallur	4.05	4.54	3.99
Orari i konsultimeve me profesorë respektohet	4.00	4.17	3.89
Që në fillim të vitit jemi të njoftuar me mënyrën e vlerësimit me lëndën përkatëse	4.13	4.41	4.29
Metodat e mësimdhënies janë bashkëkohore	4.03	4.37	4.00
Sallat e mësimit janë të pajisura mirë me mjete audio-vizuele për konkretizimin e mësimit	3.83	3.82	3.28
Raporti në mes të pjesës teorike dhe laboratorike(praktike) të lëndëve është adekuat	3.96	3.89	4.34
Studentit është i lirë që vetë të përcaktohet për lënde zgjedhore	4.11	4.6	3.96
Orari i mësimit shpallet me kohë	4.06	4.63	3.74
Orari i shpallur i mësimit respektohet nga mësimdhënësit	4.07	4.42	4.34
Programi i studimit është aktual me zhvillimet në këtë disiplinë të studimit	4.06	4.30	4.22
Programi i studimit është i krahasueshëm me programet e ngjashme në univ. e tjera	4.05	4.51	4.07
Vlera e ECTS-së për lëndën është e llogaritur sipas ngarkesës së studentit	4.08	4.34	3.99
Puna praktike jashtë institucionit aplikohet me rregull	4.11	4.03	3.91
Komunikimi i udhëheqësve të programit me studentë është në shkallën e duhur	4.06	4.11	3.87
Mundësitë e punësimit pas përfundimit të studimeve janë të njohura për studentët	3.94	4.53	3.62
Mendimi im i përgjithshëm për këtë program të studimit është pozitivë	4.08	4.47	3.68
Këtë program të studimit do t'ia sygjeroj edhe personave të tjerë	4.14	4.58	4.10

Rezultatet e vlerësimit janë në përgjithësi pozitive meqë të gjitha komponentet janë vlerësuar me 4 apo më lartë, me përjashtim të tre prej tyre që janë vlerësuar nën 4. Megjithatë, rëndësi duhet t'u kushtohet aspekteve të cilat kanë pësuar rënie në vlerësim në krahasim me vitet paraprake akademike, përkatësisht prezentimit të syllabusit me kohë, informimit të studentëve rreth literaturës dhe mënyrës së vlerësimit.

Tabela nr.3 Vlerësimi i stafit dhe lëndëve përkatëse

	Viti aktual	Vitet paraprake	
	2021/2022	2020/2021	2019/2020
Syllabusi i lëndës, i cili përfshinë përmbajtjen dhe mënyren e vlerësimit, më është prezantuar në mënyrë të detajuar në fillim të semestrit	4.24	4.29	4.24
Vijimi i mësimdhënësit gjatë semestrit ka qenë i rregullt dhe në kohë	4.28	4.27	3.99
Mësimdhënësi ka ardhur gjithmonë i përgatitur në mësim	4.33	4.34	4.19
Aktivitetet gjatë semestrit kanë krijuar mundësi që studentet të angazhohen në diskutime, aktivitete kreative, si dhe është inkurajuar ndërveprimi i studenteve (puna në grupe, dyshe etj).	4.20	4.24	4.16
Mësimdhënësi ka qenë në dispozicion të studentëve për konsultime, në Universitet apo online	4.22	4.27	4.15
Mësimdhënësi i inkurajon mendimet e ndryshme të studenteve dhe i respekton ato	4.29	4.31	4.26
Materialet e ofruara për studime gjatë semestrit ishin të pershtatshme për fitimin e njohurive dhe të shkathtësive të parapara për këtë lëndë	4.28	4.27	4.28
Materialet e ofruara nga mësimdhënësi janë publikuar me kohë në SMU, Teams apo në Moodle	4.11	4.17	4.06
Studentët kanë qenë të informuar paraprakisht për kriteret e vlerësimit të provimit/punimeve ose të punës së tyre në përgjithësi	4.27	4.25	4.12
Vlerësimi i punës së studentëve për lëndën gjatë semestrit është bërë sipas syllabusit të lëndës	4.29	4.28	4.06
Nëse mësimi është mbajtur në klasë, mjetet e konkretizimit (markerat, projektori, tabela, etj) dhe hapësira e mësimit kanë qenë në	4.33	4.23	4.09

dispozicion dhe janë shfrytëzuar mirë nga mesimdhënësi			
Mësimdhënësi ka përdorur platformën virtuale të mesimit Microsoft Teams dhe mundësitë e saj me lehtësi	4.18	4.36	4.29
Lënda ka qenë e dobishme për studentët	4.36	4.38	4.42

Nga të gjitha komponentet në tabelën e paraqitur më lartë, vetëm ai i fundit ka pësuar rënie të lehtë në vlerësim nëse e krahasojmë atë me dy vitet paraprake akademike. Përfunduar këtë aspekt, rezultatet e vlerësimit të mesimdhënësve dhe lëndëve janë pozitive, meqë të gjitha janë vlerësuar me 4 apo më lartë. Lëndët me vlerësimin më të lartë në këtë vit akademik janë Vizatim I, Grafikë dhe Histori e Artit.